



## **Kushtet e përdorimit për video-telefoninë përmes Skype**

JVA Bielefeld-Brackwede u ofron të burgosurve mundësinë e përdorimit të video-telefonisë nëpërmjet programit të komunikimit Skype. Për këtë qëllim është organizuar në sallën e madhe të vizitave, një tavolinë vizitorësh me ekran, kamera ueb dhe kufje.

Video-telefonija shërben për të ruajtur, stabilizuar dhe mbështetur marrëdhënien me kontaktet që ofrojnë mbështetje dinjitoze dhe është menduar kryesisht për vizitorët të cilët për shkak të distancës fizike, gjëndjes së tyre shëndetësore, situatës së tyre financiare ose arsyeve të tjera të mirëkuptueshme, nuk mund ose mund ta kenë të vështirë të vizitojnë insitucionin në fjalë.

Për të përdorur video-telefoninë ju nevojitet një pajisje me opsionin për tu lidhur me internetin, në të cilën është instaluar programi Skype, një kamera ueb, altoparlant dhe mikrofon, një lidhje me internetin si dhe një llogari përdoruesi Skype.

### **Lejimi i përdorimit video-telefoni**

Për tu lejuar video-telefonija me persona, i burgorusi duhet të ketë bërë më përpara kërkesë për këtë gjë. Kërkesa do të kontrollohet, duke marrë parasysh çështjet e sigurisë dhe rregulloret e insitucionet, si dhe nevojën për mbështetje dinjitoze nga kontaktet e kërkuara.

Personat kontaktues duhet të miratojnë me shkrim kushtet e përdorimit dhe të firmosin për këtë gjë deklaratën e miratimit. I burgosuri dorëzon deklaratën e plotësuar dhe të firmosur bashkë më një kopje të dokumentit tuaj identifikues, bashkangjitur në kërkesën për aprovim.

Nuk nevojitet deklarata e miratimit dhe as kopje të dokumentit identifikues tek personat nën moshën 16 vjeç.



## **Caktimi i orareve**

Të burgosurve të cilve u aprovohet kërkesa, u lejohe të përdorin video-telefoninë njëherë në muaj. Video-telefonia mundësohet vetëm pas caktimit të një orari të mëparshëm. Orari caktohet me punonjësit e departamentit të vizitave nëpërmjet telefonit (Tel.: 0521/4896-230). Kohëzgjatja e përdorimit gjatë orarit është 40 minuta. Gjatë këtij orari lejohen maksimalisht 3 persona në të njëjtën kohë. Fëmijët nën moshën 4 vjeç nuk llogariten në këtë rast. Të gjithë personat të cilët janë planifikuar për video-telefoninë duhet të përcaktohen me emër.

## **Zbatimi**

Në orarin e caktuar, një punonjës i departamentit të vizitave do të regjistrohet në Skype me llogarin përdoruese „Bi-Bra2020“, në mënyrë që ju të mund të krijoni lidhjen me llogarinë e përdoruesit që keni dhënë. Me kërkesë të punonjësit të stafit, ju lutëmi të mbani përpara kamerës ueb dokumentin tuaj të identifikimit në mënyrë që të verifikohet identiteti juaj. Pasi është verifikuar identiteti, do të krijohet lidhja me të burgosurin dhe video-telefonija mund të kryhet.

Video-telefonia përmes Skype do të mbikqyret optikisht nga një punonjës i stafit. Lidhja mund të ndërpritet pas një paralajmërimi, nëse siguria ose rendi i institucionet rrezikohet për shkak të sjelljes suaj ose të burgosurit. Nuk do të ketë paralajmërim, nëse ndërprerja e menjëhershme e video-telefonisë është thelbësore dhe e pashmangshme. Çdo ndryshim i paautorizuar të personave nga personat e kontaktit, do të sjellë si pasojë ndërprerjen e menjëhershme të video-telefonisë.

## **Mbrojtja e të dhënave**

Me vendosjen e një lidhjeje me video-telefoni transmetohen të dhënat e të brgosurit si dhe të personave kontaktues nëpërmjet lidhjes së internetit. Nuk kryhet ruajtja e të dhënave nga institucioni në fjalë.

## **Kohëzgjatja e vlefshmërisë**

Lejimi për përdorimin e video-telefonisë përmes Skype si dhe kushtet e përdorimit të lartpërmendura vlejné vetëm për JVA Bielefeld-Brackwede.